



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6886/2025

A.nr.1574/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1574/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, I.E, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1574/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, I.E.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, I.E (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 11.08.2025 përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017330, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm , gjegjësisht, për pozitën e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë” në Rajonin e Prishtina 2, të shpallur nga Inspektorati i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 06.08.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.09.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1574/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 21.03.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00017330, Për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm-Arsim i Lartë, respektivisht për pozitën e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë” në Rajonin e Prishtinës 2, me klasë të pozitës Profesional 1, shtatë (7) vende të lira pune, i hapur për aplikim nga data 22.03.2025 deri më datën 20.04.2025.

Tutje sipas provave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs dhe se i njëjti ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i'u nënshtruar vlerësimit profesional, ashtu që në testin me shkrim ka arrit 60.8 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ka arrit 15.8 pikë, gjithsejtë ka grumbulluar 76.6 pikë.

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës më datë 11.07.2025 ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me (11) kandidatë të suksesshëm.

Pas publikimit të Njoftimit të datës 11.07.2025, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj procedure. Shton se nuk është bërë vlerësim i duhur i testit me shkrim, nga ana e Komisionit të Vlerësimit, më theks të veçantë i eses, gjithashtu, pretendon se përbërja e Komisionit të pranimit është e kundërligjshme dhe është formuar nga personi pa autorizim ligjor. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procesin e rekrutimit në tërësi.

Duke qenë së kandidati N.G, si kandidat aplikues në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017340, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin Prishtina 1, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A numër A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00017340.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1574/2025, të datës 11.08.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1573/2025, të datës 01.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këtë procedurë, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1574/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1574/2025, të datës 11.08.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

\
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1574/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Ilir Ejupi;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoriatin Qendror;
- Arkivit të KPMSHCK-së.